



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 82.1 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 02.02.2021, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Rritjen e Numrit të Votueseve në Vendvotim për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021

- I. Miratohet rritja e numrit të votueseve në Vendvotim për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen më 14.02.2021, nga 750 votues në 950 votues në një vendvotim.
- II. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv i SKQZ-së që këtë vendim t'ia përcjell Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve dhe Këshillave të Vendvotimeve.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 02.02.2021

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Data / Datum	02.02.2021
Për / Za	Komisionin Qendror të Zgjedhjeve
Përmes / Preko	Burim Ahmetaj, Kryeshef Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së
Nga / Od	Departamenti i Operacioneve Zgjedhore
Kopje / Kopija	
Lënda / Predmet	Rekomandim për rritjen e numrit të votuesve për vendvotime për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, 14.02.2021

Bazuar në Planin Operacional për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datën 02.02.2021 certifikon Listën Përfundimtare të Votuesve.

Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, asnjë vendvotim brenda Qendrës së Votimit nuk tejkalon numri 750 votues. Përrjashtimet nga kjo rregull mund të autorizohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve¹.

Caktimi i votuesve në vendvotime, bëhet sipas renditjes alfabetike të mbiemrave.

Duke u bazuar edhe në kapacitetet që kanë qendrat e votimit në posedimin e hapësirave/ klasave që mund të shfrytëzohen si vendvotime dhe për arsye të kufizimit të shpenzimeve dhe duke u bazuar edhe në vendimet e marra për këtë çështje në proceset e kaluara zgjedhore, dhe gjithashtu në autorizimet që Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme i jep KQZ-së, sipas nenit 82.1,

Rekomandojmë që:

- a) Numri i maksimal i votuesve për vendvotim të jetë nëntëqind e pesëdhjetë (950).

¹ Ligji Nr. 03/L-256, Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 82.1.